



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 4, datë 21.05.2024

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:15

Data e mbajtjes së mbledhjes : 21.05.2024

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako, si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje të gjithëve.

Të nderuar Këshilltarë ! E nderuar Kyetare ! Të nderuar të pranishëm!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës.

Në këtë mbledhje, siç jeni vënë në dijeni dhe nëpërmjet email-it të dërguar nga Sekretaria, do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë, një projektvendim i propozuar nga Kryetari Këshillit si dhe 2 raporte informimi nga drejtori të Bashkisë Durrës. Ftoj sekretaren të procedoj me thirrjen e emrave të Këshilltarëve.

Dorina Milja: Përshëndetje.... Fillojmë.

Ardian Muka ... Mungon.....deri tek.... Florian Tahiri...Prezent.

32 Këshilltarë në sallë.

V.O... *Hyn me vonesë gjatë mbledhjes këshilltarët Edlira Shemsi, Bledar Prizreni, Zhuljeta Ngota, Ermal Braholli, Luan Nezha, Kontjana Kuçi, Samet Vata. Gjithsej 39 këshilltarë.*

Ani Dyrmishi: Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.
Sot në rend dite kemi 20 pika. Po kaloj në leximin e tyre.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6 % DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN PRILL 2024
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E RAPORTIT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2023
Pika 3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË TRASHËGUARA NGA VITI 2023
Pika 4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR KORRIGJIM GABIMI MATERIAL NË VENDIMIN NR. 160, DATË 18.10.2023 TË KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS “PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 71, DATË 20.07.2020, PËRSA I PËRKET Z. ALTIN XHAFA, NR. 36, DATË 09.05.2022 PËRSA I PËRKET Z.PETRIT HAJRO, NR. 32, DATË 26.03.2021, PËRSA I PËRKET Z. LIRIM IBRAHIMI, NR. 67, DATË 17.03.2023, PËRSA I PËRKET Z. QANI XHABLI DHE Z. XHEVAHIR XHABLI, NR. 37, DATË 09.05.2022 PËRSA I PËRKET Z. PANDELI SHTËMBARI, Z. THOMA SHTËMBARI, ZNJ. VIOLETA SHTËMBARI DHE ZNJ. ADRIANA SHTËMBARI, NR. 77, DATË 28.06.2021 PËRSA I PËRKET Z. RUSTEM GJERGJI”
Pika 5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 104, DATË 30.03.2023 PËRSA I PËRKET ZNJ. SHQIPE DAJA, NR.99, DATË 30.03.2023 PËRSA I PËRKET Z. ALFRED DYLAVER BERISHA, NR.61, DATË 28.02.2023 PËRSA I PËRKET ZNJ. SYLE DURMISHI, ZNJ.QËNDRIME DURMISHI, Z. FABRINIO DURMISHI, ZNJ. ALESIA DURMISHI, Z. AGIM DURMISHI DHE Z. MERSIN DURMISHI, NR. 109, DATË 19.10.2022 PËRSA I PËRKET ZNJ. SUZANA HAKANI, Z. BULJAN HAKANI, Z.SHUSTER HAKANI DHE Z. MIRSEL HAKANI.
Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E VLERËS MESATARE TË QIRASË SË APARTAMENTEVE TË BANIMIT PËR EFEKT TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR KATEGORITË, QË GËZOJNË PËRPARËSI NË SUBVENCIONIMIN E QIRASË NË TREGUN E LIRË.
Pika 7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE QË PËRMBUSHIN KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E GRANTIT TË MENJËHERSHËM, QË DO TË AKORDOHET NGA MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT NË FAVOR TË BASHKISË DURRËS PËR FAMILJET QË PËRFITOJNË ULJE TË VLERËS SË KONTRATËS PËR VITIN 2024.
Pika 8. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VKB-NË NR. 196, DATË 22.12.2023 “PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2023-2024”, I NDRYSHUAR.

Pika 9. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E “PLANIT TË PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT NË ARSIMIN PARASHKOLLOR NË BASHKINË DURRËS PËR VITET 2024-2026”.
Pika 10. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2024.
Pika 11. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR NJË SHITESË NË VKB-NË NR. 475, DATË 23.12.2017 “PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË RI TË ADRESAVE TË BASHKISË DURRËS”, I NDRYSHUAR.
Pika 12. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.3, DATË 6.02.2024 “PËR MIRATIMIN E HARTËS SË PËRGJITHSHME TË PLAZHEVE TË LEJUARA KU DO TË USHTROHET VEPRIMTARIA SI STACION PLAZHI, PLAZHET PUBLIKE PËR VITIN 2024 SI DHE PLOTËSIMIN E SAJ ME ELEMENTËT E NEVOJSHËM LIDHUR ME STANDARTET E KËRKUARA NGA AKTET LIGJORE NË FUQI”.
Pika 13. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR. 32, DATË 26.03.2021, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L. 17, RRUGA “LURA”, PALLATET NR. 1&3, DHE RRUGA “AHMET DAKLI”, PALLATET NR. 15&23, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR, PËRSA I PËRKET ZNJ. MIRIANA SHKODRA”.
Pika 14. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 67, DATË 14.07.2020 PËRSA I PËRKET Z. ASTRIT GJERGJI, ZNJ. FLORA GJERGJI, Z. DORNARD GJERGJI, ZNJ. OSLANA GJERGJI, Z.FATMIR GJERGJI, ZNJ. MYZEJENE GJERGJI, ZNJ. ROSSELLA GJERGJI DHE ZNJ.KIARA GJERGJI, NR. 72, DATË 20.07.2020 PËRSA I PËRKET Z. BESIM BERBERI, NR. 32, DATË 26.03.2021 PËRSA I PËRKET Z. XHEVDET QERIMI DHE ZNJ.MYZEJEN QERIMI, NR. 93, DATË 26.07.2021 PËRSA I PËRKET Z. ANDI ALLIU, Z.IGLI ALLIU, ZNJ.BESMIRA ALLIU DHE ZNJ.JEME ALLIU, NR. 118, DATË 27.10.2022 PËRSA I PËRKET Z. MENTOR ZENE DHE ZNJ. REZARTA MAGANI
Pika 15. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUNDI I RI, TË PASURISË ME NR. 101/2, E LLOJIT TRUALL, ME SIPËRFAQE 1664 M ² , ME VENDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 3541.
Pika 16. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN PËRFUNDIMTAR DHE PËRDITËSIMIN E TË DHËNAVE, TË PRONËS ME NR. 4, TË LISTËS SË TRANSFERIMIT, MIRATUAR ME VKM NR.538, DATË 07.8.2012, ME EMËRTIMIN “TRUALL”, ME NR. PAS.10/34, ZK 2590, KUÇOK, MANËZ NË FUNKSION TË NDËRTIMIT TË SHKOLLËS SË MESME KUÇOK, MANËZ.
Pika 17. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 536, DATË 1.5.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË

	TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË DURRËS TË QARKUT TË DURRËSIT”, TË NDRYSHUAR.
Pika 18. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit nga Kr. i Këshillit	PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VKB NR.123, DATË 13.07.2023 “PËR MIRATIMIN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHËM TË KËSHILLIT BASHKIAK DHE PËRBËRJEN E TYRE”.
Pika 19. Informim	RAPORTIM MBI “PARANDALIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE” .
Pika 20. Informim	RAPORT MBI AUDITIMIN E BRENDSHËM TË NDËRMARRJEVE NË VARËSI TË BASHKISË PËR VITIN 2023.
*****	DISKUTIME DHE PYETJE NGA KOMUNITETI.

Këto ishin pikat e rendit të ditës.

Atëhere, kemi ndonjë koment përsa i përket rendit të ditës?

Po z. Xhelili.

Roland Xhelilaj: Duke qënë se u bë një kohë, që përfaqësuesja e grupit tonë Partisë Socialiste si nënkryetarja e këshillit ka marrë një detyrë tjetër të rëndësishme në bashki, kërkojmë që brenda rregullave sot të fusim një pikë të re në rendin e ditës: Për emërimin e pasueses së saj meqënëse i takon grupit tonë.

Ani Dyrmishi: Pra, të shtojmë në rendin e ditës një pikë “Për zgjedhjen e nënkryetares së këshillit bashkiak?”

Roland Xhelilaj: Po

Ani Dyrmishi: Atëherë kush është pro me rendin e ditës me shtimin?

Kundra?Nuk ka.

Abstenim?Nuk ka.

Atëherë miratohet rendi i ditës me 38 vota pro.

- Atëherë kalojmë në projektvendimin për **pikën 1**. I japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit, z. Florian Tahiri, po znj. Shemsi më fal.

Edlira Shemsi: Komisioni për Çështjet Sociale, Barazisë Gjinore mbasi u mbledh e miratoi listën për muajin prill për qytetarët që marrin ndihmën ekonomike brenda fondit 6 % dhe të ardhurave të bashkisë. Në këtë listë kanë dal tre qytetarë nga lista ekzistuese dhe janë futur 5 qytetarë të rinj. Shifrat janë pak e shumë ato shifra, 156 qytetarë për muajin prill. E hedhim në votim, pasi ne si komision e kemi miratuar.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 1, kemi?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1?

Kundra?....

Abstenim?..... Nuk ka

Me 38 vota pro miratohet pika 1 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 2**. I japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, z.Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Me numrin e vogël të përfaqësuesve të opozitës, konkluzioni jonë: Kalon pikën 2 me një abstenim nga përfaqësuesi i Partisë Demokratike Joni.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 2?

Po z. Myshketa.

Jonuz Myshketa: Përshëndetje!

Për materialin që na u vu në dispozicion përsa i përket pikës dytë kisha disa komente, që doja t'i ndaja me ju të nderuar kolegë.

Vë re tek zëri në tabelën e të ardhurave

Ani Dyrmishi: Joni, të lutem afroje pak mikrofonin.

Joni Myshketa: Tek zëri i tabelave të të ardhurave, e cila është tabela përbërëse ku përfshihen të ardhurat e bashkisë së Durrësit, transfertat e buxhetit qendror, huamarrjet dhe trashëgim nga viti i shkuar. Të ardhurat për vitin 2023, pra faktike, jo plani, janë 1 mld e 851. 571 lekë ndërkohë që transfertat nga buxheti qendror zënë pjesën më të madhe të të ardhurave gati 7 mld e pak lekë dhe fondet e trashëguara. Po të vëmë re shpenzimet, vetëm shpenzimet e personelit janë 1 mld e 500 milion lekë, pra në raport me të ardhurat e veta bashkia e Durrësit, lë për të dëshiruar, ç'ka do të thoja që është totalisht e varur nga buxheti i shtetit. Duke patur parasysh potencialin që ka Bashkia e Durrësit ose Durrësi si qytet, i cili mbahet për historinë dhe është qyteti i dytë ekonomik për nga rëndësia që është dhe turistik dhe kulturor gjithashtu.

Në raport me shpenzimet duhet të ndalesha dhe tek zërat e shpenzimeve ku zënë pjesën më të madhe. Vë re që shpenzimet më të mëdha janë pjesë të shpenzimeve të mbetjeve urbane ku arrijnë 27 % vlera totale. Duhet të jap një shpjegim i kësaj vlere. Pak a shumë sipas hulumtimit që kam e kam një përgjigje, për ju si institucion i bashkisë. Dhe vë re që shpenzimet për trashëgiminë kulturore dhe vendet artistike kulturore arrijnë vetëm 2 % të shpenzimeve totale, duke pasur parasysh që bashkia duhet të ketë trashëgiminë kulturore si një rol në Ballkan. Një pikë tjetër kanë dhe shpenzimet për përkujdesjen sociale dhe strehimin social ku ka një shumë modeste në 4.7 % të shpenzimeve totale.

Do ndalem në të gjitha pikat, por thashë të mos iu ngarkojë.

Atëherë, një tjetër është ajo e taksës së pasurisë së paluajtshme, një tjetër taksë e pasurisë së paluajtshme është ajo e 500 milion lekë të reja, duke u mbështetur në rritjen e numrit të abonentëve për taksën e kërkesës së popullatës thuhet në raportin tuaj, nga 40 mijë në 70 mijë abonentë, me rritjen e pjesës së të ardhurave nga kjo taksë e biznesit. Për vitin 2023 kjo taksë ka rekrutuar në mbledhjen e saj 331 milion e 374.350 ose 64 %, është një realizim i ulët, në lidhje me atë ç'ka do të mblidhet dhe ka një defiçent prej 168 milion lekësh, nuk janë pak, që nuk janë korrur nga Bashkia Durrësit. Është bërë dhe një shpjegim, si mund të gjejmë një zgjidhje për shkak të këtij tatimi të vitit 2023.

Jemi më pas te realizimi i një norme tepër modeste 20 % të taksës së pronës, e cila për hir të së vërtetës nuk lidhet vetëm me bashkinë, por një problem të mbartur të pronave.

Kemi më pas taksën e pastrimit të largimit të mbeturinave nga biznesi, e cila mesa pash vjen me rritjen e shpenzime, pra 29 euro për ton, pasi shkon në Tiranë, inceneratorin e Tiranës e kjo një temë tjetër problematike. Kjo tarifë sipas të njëjtit raport sqarohet në mënyrë direkte për subjekte, hapja e subjekteve të reja, të cilat do ta nënvizoj në raport me vitin e kaluar të certifikimit fiskal duke përfshirë pezullimin dhe mbylljen. Kjo tarifë për vitin 2022 ka qënë 164 milion lekë, në 2023 është realizuar në vlerën 169 milion lekë pra, ose 89 % e planit krahasuar me vitin e kaluar. Bie ndesh me një taksë tjetër, që është taksë e tabelës, pra për vitin 2023 për taksën e tabelës thuhet janë arkëtuar më pak në krahasim me vitin 2022 dhe kemi një realizim prej 1 milion e 500 e sa mijë lekë më pak se në 2022, në pjesën e totalit të një numri në ulje të numrit të tabelave identifikuese dhe reklamuese. Pra, shohim një mospërputhje ndërmjet këtyre dy pikave. Pra në pikën e parë kemi në tarifën e pastrimit kemi një menaxhim të mirë për shkak të rritjet të numrit të subjekte dhe në pikën tjetër kemi një reklamim më të pakët të numrit të subjekteve. Shkon ndesh në pikën më lartë, pasi duke pasur parasysh rritjen e numrit të subjektet, subjektet në fazën e parë janë në fazën e marketingut agresiv dhe duhet të kenë një reklamim më të madh. Kjo lë për të dëshiruar dhe është një pyetje më shteruese nga ana juaj.

Tarifa e plazheve private për vitin 2023 ka një realizim prej 106 milion lekësh të reja afërsisht dhe 69 % e planit dhe 6 milion e 100 mijë lekë më pak se në vitin 2022, kjo për arsye të uljes së numrit të aplikimeve në krahasim me vitin e kaluar. Pyetja shtrohet, ulja e aplikimeve a ka sjell ndryshimin e hapësirave publike për banorët? Duhet të kemi një raport narativ në lidhje me këtë pjesë, pasi pas ankesave të shumta të banorëve nuk na rezulton.

Këto ishin disa nga pikat për të cilat kërkoj një shpjegim dhe pse pikat lidhen me miratimin e kësaj pike nga ana jonë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit z. Myshketa.

Kryetare!

Emirjana Sako: Faleminderit për pyetjet.

Ne kemi bërë një raport të detajuar të monitorimit të buxhetit të bashkisë dhe që është një detyrim ligjor në këtë fazë të vitit. Ju i prekët një nga një, por në vija të përgjithshme, pra të flasim për totalin. Ne kemi realizuar të ardhurat deri në 87 % për vitin 2023, e cila nuk ka qënë asnjëherë kaq e lartë. Shpenzimet janë arritur në nivelin e 78 % pra është, nëqoftëse do bëjmë një mesatare

të gjitha atyre shifrave që përmendet por dhe të tjerat që nuk i preket nga fjala juaj, sigurisht që ka vënd për ta përmirësuar punën në terren.

Ka të bëj shumë dhe ndërgegjegjësimi që kanë qytetarët për pagesën e taksave dhe detyrimet vendore si një detyrim ligjor. Me drejtoritë përkatëse, këtë vit kemi filluar dhe kontrollin në terren për kryesisht zonat bregdetare zonën e Ishmit, Gjirin e Lalëzit ku kemi një rritje të numrit të ndërtimeve aty prej lejeve të miratuara nga qeveria shqiptare dhe KRRT-ja në mënyrë që këto subjekte, të cilat ndodhen në këto zona, pra qofshin ato turistike qoftë ato që kanë subjekte hotelerie e të tjera me radhë, në mënyrë që t'i identifikojmë dhe t'i ngarkojmë si qytetarë të Durrësit, për të rritur nivelin e mbledhjes së të ardhurave tona. Pastaj për secilin zë sigurisht që ne do të vëmë në dispozicion përgjigje specifike për pyetjen.

Përsa i takon menaxhimit të mbetjeve ka një buxhet prej 965 milion lekësh në buxhetin e bashkisë, ku nga këto 331 janë për paga e sigurimet shoqërore, pra diku 30 %-shi, operative rreth 289 milion lekë, pra që do të thotë nafta, vegla pune, pjesë këmbimi për mjetet, siguracionet e tyre e të tjera me radhë. Dhe 261 milion është pagesa që ne i detyrohemi landfill-it të Sharrës, për depozitimin e mbetjeve. Dhe këtu kemi politika për të bërë uljen e këtij volumi, e cila do të vi patjetër pas hartimit të mastëplanit të mbetjeve, ku do të përcaktohen, ku do të përcaktohet dhe stacioni i transferimit dhe ndërtimi i stacionit të transferimit do të sjelli fillimin e konceptit të diferencimit që në burim të mbetjeve dhe patjetër do të çoj në uljen e kësaj tarife.

Këtë vit duam që bizneset, të cilat i quajmë ndotës të mëdhenj, pra ata që kanë një impakt më të madh në volumin e mbetjeve, t'i detyrojmë të lidhin marrëveshje kontraktuale me subjektet e licensuara për largimin e mbetjeve, në mënyrë për ta hequr këtë faturë nga qytetarët e Durrësit. Dhe kjo tarifë mbulohet 90 % nga qeveria shqiptare, pra ne sot faturën e depozitimit e kemi të mbuluar nga ministria përkatëse. Kemi pasur dhe disa investime të vogla gjatë vitit 2022, të cilat janë likuaduar në vitin 2023. Dhe nëqoftëse do flasim për një përmbledhje, nga tarifa e pastrimit ne marrim 25% që shkon në buxhetin e menaxhimit të mbetjeve nga buxheti i shtetit 25%, pra ky 90 % në peshën specifike të gjithë buxhetit është 25% dhe nga të ardhurat e tjera kemi 50%. Të ardhurat e tjera janë taksat e tjera, tarifatat e tjera të qytetit, por dhe tarifatat dhe taksat e infrastrukturës së ndërtimit, të cilat mbulojnë menaxhimit e mbetjeve. Vlerësojmë që është një nga programet më të rëndësishme që ka bashkia e Durrësit, sepse jemi një qytet bregdetar dhe kemi prioritet pastrimit dhe mbajtjen pastër të qytetit për t'i shërbyer sa më shumë turizmit në mënyrë që numrat e turistëve dhe vizitorëve të jenë në rritje. Shpresojmë që ky vit të jetë i mbarë.

Ani Dyrmishi: Faleminderit Kryetare.

Koment tjetër?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 2 të rendit të ditës? ...

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro dhe 3 apstenim miratohet pika 2 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 3**. I japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, z.Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Për pikën 3, anëtarët e Komisionit ishin të gjithë dakort.

Ani Dyrmishi: Faleminderit!

Atëherë komente përsa i përket pikës 3, kemi?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3? ...

Kundra? ... nuk ka

Abstenim? ... nuk ka

Atëherë me 39 pro, miratohet pika 3.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 4**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, znj.Devolli.

Edlira Devolli: Faleminderit Kryetar.

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike, pasi shqyrtoi çështjen vendosi ta kaloj për votim në seancë.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike zonja Musaraj.

Joniada Musaraj: Faleminderit Kryetar.

Ne si komision u mblodhëm, e miratuam pikën katër dhe vendosëm ta kalojmë në Këshill. Faleminderit.

Ani Dyrmyshi: Komente për pikën 4, ka nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Kundra?...

Abstenim... Nuk ka.

Me 39 vota pro miratohet pika 4.

- Kalojmë **në pikën 5**. I jap fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, znj.Devolli.

Edlira Devolli: Po kryetar, komisioni u mblodh, shqyrtoi çështjen dhe vendosi ta kalojë për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, znj Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe për pikën 5 propozojmë ta kalojmë në Këshill. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 5, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.
Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës? ...
Kundra?...
Abstenim?... Nuk ka.

Atëherë me 38 vota pro dhe 1 pa votuar miratohet pika 5.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 6**. Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, znj Musaraj.

Joniada Musaraj: Komisioni ynë dhe edhe për pikën 6 propozojmë të votohet në Këshill.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 6, kemi?
Nuk ka.
Kush është pro për miratimin e pikës 6 të rendit të ditës?...
Kundra?...
Abstenim?... Nuk ka.

Me 39 vota pro miratohet pika 6.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 7**. Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, znj Musaraj.

Joniada Musaraj: Për pikën 7 propozojmë që të kaloj në Këshill.

Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 7, kemi nga ana këshilltarëve?
Komente nuk ka. Kalojmë në votim.
Kush është pro miratimit të pikës 7 të rendit të ditës? ...
Kundra?...
Abstenim? ... Nuk ka .

Atëherë me 38 vota pro miratohet pika 7 e rendit të ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 8**. I japim fjalën Komisionit të Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit znj. Denisa Luarasi.

Denisa Luarasi: Përshëndetje!

Dhe për pikën 8 komisioni ra dakort ta kalojë për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit znj. Luarasi.

Atëherë komente për pikën 8, kemi?
Komente nuk ka, kalojmë në votim.
Kush është pro miratimit të pikës 8 të rendit të ditës? ...
Kundra? ...
Abstenim? ...Nuk ka.

Me 38 vota pro miratohet pika 8.

- Kalojmë në pikën 9. Znj. Luarasi.

Denisa Luarasi: Dhe për pikën 9 komisioni ynë ra dakord, por përpara se, doja t'ju njoftoja se për këtë pikë u organizua një dëgjesë publike këtu në sallën e Këshillit për planin e vitit 2024-2026. Plani do të ketë një rol të rëndësishëm për bashkinë e Durrësit, i cili synon të përmirësoj në mënyrë të ndjeshme proceset që lidhen me arsimin parashkollor, konkretisht planifikim strategjik përpara i përket riorganizimit të infrastrukturës së kopshtit, me qëllim përmirësimin e shërbimit në kopshte, që janë brenda shkollave ose kopshteve, që kanë nevoja imediate për restaurim veçanërisht ndodhen në njësi administrative. Zhvillimi i burimeve njerëzore të bashkisë në çështjet e arsimit parashkollor përmes ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet drejtuese të administratës së bashkisë për hartimet, zbatimet dhe monitorimit të planit të përmirësimit. Finalizimin e rregullores së funksionimit të kopshteve dhe organizimit të shërbimit në bashki si dhe implementimi i tyre. Bashkëpunimi i ngushtë me prindërit dhe komunitetin për të ndërgjegjësuar për rëndësinë që ka kopshti për zhvillimin e fëmijës. Shtim personeli edukativ dhe mbështetës. Mbledhja dhe zbatimi i taksës së përshkohshme në arsimin parashkollor përgjatë vitit 2024. Kthimin e tre kopshteve me drekë si kërkesë e komunitetit në njësinë administrative të bashkisë Durrës, specifikisht kopshti me ushqim “Isuf Ferra”, Nishtullë, Durrës, kopshti me ushqim “Rreze Drite” në fshatin Kucok njësi administrative Manëz dhe kopshti “Lulet e Pranverës” të blloku i banesave të reja nga rindërtimi Manëz.

Ky plan ka një impakt, ka një shtrirje të gjerë përpara i përket grupeve që i prekin dhe me impakt social, pasi kryesisht i vjen në ndihmë nënave me fëmijë, që janë të punësuar, fëmijëve të kopshtit dhe komunitetit të bashkisë Durrës.

Ky ishte plani ju ftoj ta votoni.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 9, kemi?

Po, z. Myshketa.

Jonuz Myshketa: Kam një sygjërim për pikën 9.

Me planin në përgjithësi jam dakort, inspirimi në lidhje me këtë pikë vjen nga ndodhi familjare të cilët kanë fëmijë me arsim parashkollor ose para se hyn në fillore, pasi dua ta them, të gjithë prindërit kanë probleme me pjesën e mbajtjes së fëmijëve pas orarit shkollor.

A kemi mundësi në bashki dhe me Ministrin e Arsimit të krijojmë klasa të veçanta ku fëmijët si në shkolla private, ku mund ta rrisin kreativitetin e shkollave dhe arsimit tonë fillor, të krijojmë klasa me 2 mësues për klas me një pagesë më të cilin prindërit kanë mundësi të ofrojnë dhe të lejohen të rrinë ku mund të bëjnë detyrat, por mbi të gjitha të jenë të survejuar brenda ambienteve të shkollës nga mësues deri në momentin që prindërit dalin nga puna. Do ishte një ndihmë shumë e madhe për komunitetin. Pjesën ligjore gjithsesi mund ta zgjidhi bashkia, por me një bisedim me ministrinë, besoj se do jetë një ndihmë goxha e madhe për komunitetin dhe arsimin parashkollor.

Emiriana Sako: Mementalisht ne kemi në dorë ose kompetencë në bazë të ligjit infrastrukturën, pjesën e menaxhimit të saj, investimet në infrastrukturë dhe nuk ndërhyjmë në kurikula, është e vërtetë që mund të ketë familje të cilat duan të gjejnë një zgjidhje për afterschool-et pas mësimit. Në disa qendra sociale ne këto shërbime i japim, por i japim për familjet në nevojë, ato që janë pre e dhunës apo që kanë fëmijë të spektrit të autizmit e të tjera me radhë, por në shkolla nuk mundet as bashkia të vendos një program të tillë, sepse është pjesë e kurikulës, megjithatë nuk na kushton asgjë që të bëjmë një kërkesë Ministrisë, mbase mund të kenë një program pilot, që mund të aplikohet në shkolla të caktuara dhe mund të jetë funksional dhe i mirëpritur, pra duhet t'i drejtoheni ministrisë për këtë kërkesë.

Jonuz Myshketa: Okay (okej)

Ani Dyrmishi: Koment tjetër përsa i përket pikës 9, ka?

Nuk ka. Atëhere kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 9 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim?.... Nuk ka.

Me 38 vota pro miratohet pika 9.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 10**. Znj. Devolli.

Edlira Devolli: Faleminderit .

Komisioni u mblodh dhe vendosi ta kalojë për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë znj.Xhiliola Doçi.

Xhiliola Doçi: Përshëndeje!

Dhe komisioni ynë e diskutoi dhe miratoi, vendosi që kjo pikë t'i kaloj këshillit bashkiak për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit znj. Doçi.

Komente për pikën 10, kemi?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 10 të rendit të ditës? ...

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

Atëherë me 38 vota pro miratohet pika 10.

- Kalojmë në projektvendimin **për pikën 11**. I japim fjalën Komisionit të Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit znj. Denisa Luarasi

Denisa Luarasi: Përshëndetje.

Dhe për pikën 11, Komisioni ynë ra dakort. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 11, ka?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 11 të rendit të ditës? ...

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

Me 38 vota pro miratohet pika 11.

- Kalojmë **në pikën 12**. I japim fjalën Komisionit të Politikave të Zhvillimit të Turizmit z.Renald Koka.

Renald Koka : Komisioni u mbledh dhe ra dakort ta kaloj në votim.

Ani Dyrmishi: Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës z.Munir Konesha.

Munir Konesha: Komisioni ra dakort e miratoi në mënyrë unanime, ja kalojmë këshillit për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 12, ka?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 12 të rendit të ditës? ...

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

Me 38 vota pro miratohet.

- Kalojmë **në pikën 13**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, znj.Devolli.

Edlira Devolli: Komisioni u mbledh, shqyrtoi çështjen dhe vendosi ta kalojë për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, znj Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe Komisioni ynë propozon që të votohet në Këshill. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit

Komente përsa i përket pikës 13, ka?

Komente nuk ka.

Kush është pro miratimit të pikës 13 të rendit të ditës?

Kundra?.....

Abstenim?Nuk ka.

Atëherë me 38 vota pro miratohet dhe pika 13.

- Kalojmë **në pikën 14**. I jap fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, znj.Devolli.

Edlira Devolli: Komisioni u mbledh, shqyrtoi çështjen dhe vendosi ta kalojë për votim.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, znj Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe komisioni vendosi që të votohet në Këshill pika 14. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 14, kemi?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 14 të rendit të ditës? ...

Kundra?...

Abstenim?... Nuk ka.

Atëherë me 38 vota pro miratohet.

- Kalojmë **në pikën 15**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, znj.Devolli.

Edlira Devolli: Komisioni vendosi ta kalojë për votim në seancë.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, z. Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Komisioni u mbledh dhe në unanimitet e kalon për votim në Këshill Bashkiak.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 15, ka?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 15 të rendit të ditës? ...

Kundra?...

Abstenim?... Nuk ka.

Atëherë me 38 vota pro miratohet dhe pika 15.

- Kalojmë **në pikën 16**. I japim fjalën Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, znj.Devolli.

Edlira Devolli: Komisioni u mbledh, shqyrtoi çështjen dhe vendosi ta kalojë për votim në seancë.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, z.Markola.

Hekuran Markola: Edhe pika 16 kalon me unanimitet për votim në Këshill Bashkiak.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 16, ka?

Llesh Çuni : Kam unë një koment.

Ani Dyrmishi: Po z. Çuni.

Llesh Çuni: Kam unë një koment, meqenëse i përket banorëve të Manzës, pjesë e së cilës jam dhe unë. Me miratimin e këtij projektvendimi, pjesë e të cilit jam dhe unë dhe për këtë ndihem shumë komod sot, marrin përgjigje shteruese dhe nja dy kolegë, të cilët kanë qenë shumë skeptik përsa i përket ndërtimit të gjimnazit të Manzës. Ai nuk i shërben vetëm Kuçokës ka një zonë shumë më të gjerë sesa Kuçoka.

Me miratimin e këtij projektvendimi i hapim rrugë procedurave të mëtejshme ligjore për të filluar ndërtimi i këtij gjimnazi, edhe me këtë rast për të mos u zgatur dhe bezdisur kolegët, falenderoj publikisht kryetaren e bashkisë me stafin e saj që i ndjekin me përgjegjësi, të gjitha problemet që kanë të bëjnë me rindërtimin në njësitë administrative siç është kjo e Manzës, por në të gjithë territorin. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit

Koment tjetër ka?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 16 të rendit të ditës? ...

Kundra?...

Abstenim?... Nuk ka.

Atëherë me 38 vota pro miratohet dhe pika 16.

- Kalojmë **në pikën 17**. znj.Devolli.

Edlira Devolli: Komisioni u mbledh, shqyrtoi çështjen dhe vendosi ta kalojë për votim në seancë.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

z. Markola.

Hekuran Markola Edhe pika 17 kalon për votim në Këshill Bashkiak.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 17, kemi?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 17 të rendit të ditës? ...

Kundra?...

Abstenim?... Nuk ka.

Atëherë me 38 vota pro miratohet dhe pika 17.

- Kalojmë **në pikën 18**. Komisioni i Rregullores dhe Çështjeve Juridike, znj. Devolli.

Edlira Devolli: Komisioni u mbledh, shqyrtoi çështjen dhe vendosi ta kalojë në seancë.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Komente për pikën 18, ka ?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 18, të rendit të ditës? ...

Kundra? ...

Abstenim? ... Nuk ka.

Atëherë me 38 vota pro miratohet.

- **Pika 19**, I japim fjalën për “Raportim mbi “Parandalimin e dhunës me bazë gjinore”
Znj.Meme Xhaferaj.

Meme Xhaferaj (*Drejtoresh e Shërbimit Social në bashki*): Lidhur me punën për rritjen e barazisë gjinore në nivel lokal dhe punën parandaluese në fakt që bëhet për rastet e dhunës në familje dhe kryesisht do i referohem punës për vitin 2023, Drejtoria e Shërbimit Social, stafi i Drejtorisë së Shërbimit Social dhe stafet e qendrave që ofrojnë shërbime të kujdesit social e kanë fokusuar punën në tre shtylla kryesore nëse do të ndaleshim, që i bie në promovimin e barazisë gjinore ndërmjet burrave dhe grave vajzave dhe meshkujve, të rinjve dhe të rejave si dhe në menxhimin e rasteve për t'i garantuar mbrojtje dhe shërbim integruar viktimave të dhunës në familje si dhe në aktivitete të tjera ndërgjegjësuese me fokus vëmendje ndaj qytetarëve për t'i promovuar siç thamë barazinë gjinore dhe edukimi sidomos ndërqytetar si dhe rritjen e kapaciteteve të stafit të drejtorisë.

E gjithë kjo punë sigurisht që bëhet në partneritet me shoqërinë civile, por puna jonë në fakt është ndërsektoriale dhe është e lidhur dhe me struktura të tjera rajonale dhe lokale në territorin e Bashkisë Durrës. Ju e keni parë dhe në material sigurisht që është baza ligjore ajo që ne e kemi detyrë edhe funksion për t'i realizuar të gjithë këto punë, por ndërkohë janë dhe një sërë dokumentash, është “Strategjia në nivel kombëtar për arritjen e barazisë gjinore“ dhe Bashkia Durrës ndërkohë ka hartuar edhe “Planin vendor për barazinë gjinore në nivel vendor“, ku aty janë të parashikuar një sërë objektivash, masa dhe veprime konkrete për arritjen e barazisë gjinore dhe sidomos integrimin e rasteve që ne menaxhojmë, raste të dhunës në familje, i cili është një fenomen që kërkon një vëmendje të shtuar jo vetëm nga punonjësit tonë por edhe të gjithë faktorët e tjerë.

Gjatë vitit 2023 dhe gjatë kohës që u hartua dhe ky plan vendor me urdhër të kryetares së bashkisë, është ngritur një komision për barazinë gjinore në nivel bashkie, ku aty përfaqësues janë drejtoritë kryesore të Bashkisë Durrës. Ndërkohë ne po punojmë dhe kjo është detyrimi ligjor për ngritjen e Njësisë të Vlerësimit të nevojave në çdo njësi administrative, këto ndërkohë janë objektiva dhe

aktivitete të parashikuara në planin e veprimit për barazinë gjinore. Vitin që kaloi kemi ngritur tre njësi, këto janë një suport i madh për indentifikimin dhe menxhimin jo vetëm të rasteve të dhunës në familje por çdo rasti dhe individ që ka nevojë për mbrojtje dhe përfshirje sociale.

Fokus të veçantë kanë sigurisht aktivitetet që kanë karakter edukues, promovues dhe ndërgjegjësuës jo vetëm gjatëmbëdhjetë ditët që tashmë kjo është traditë për të gjithë aktorët që zhvillohen me në fokus kundër dhunës me bazë gjinore, por ndërkohë ne kemi kalendar për të gjithë vitin me aktivitete, të cilat përgjithësisht jo vetëm me specialist që janë pranë drejtorisë por kryesisht me qendrat që ofrojnë shërbime me bazë komunitare, ku zhvillohen një sërë aktivitete me të rinj, me prindërit, me familjen dhe që kanë në fokus edukimin dhe parandalimin e një sërë dukurish jo vetëm të dhunës në familje por edhe kriminalitetit, trafikimit dhe qenieve njerëzore, ato fenomene në fakt që janë shqetësuese dhe për shoqërinë.

Aktivitetet që kanë në fokus kryesisht për t'i ardhur në ndihmë dhe grave, kryetarja pak a shumë e përmendi që ofrojmë programe edukimi por edhe afterschool-et për mbajtjen e fëmijëve, për mbarëvajtjen e tyre në mësim, për t'i lehtësuar sadopak nënat apo prindërit, për t'i lënë fëmijët dhe më tej sidomos dhe ato që punojnë në orare të zgjatura. Kjo gjë është parë e nevojshme edhe në planifikimet e buxhetit ku ne kemi shtuar çdo vit buxhetin për qendrat sociale duke shtuar pjesë të strukturave, edukator, psikolog, punonjës social, sepse e shofim shumë të nevojshëm këshilluesin në familje, i cili mund të parandalojë shumë problematika që në fillesa pa u thelluar dhe agravuar duke shkuar pastaj më tej në krime.

Pak a shumë unë i përmenda në mënyrë të përmbledhur që mos të rrija të lexoja materialin për të mos ju bezdisur juve se mua nuk më kushton gjë ta lexoj të gjithë materialin, por kryesisht nëse do t'i referoheshim Qendrës së Shërbimeve Emergjente, e cila është një qendër që menaxhohet në fakt nga bashkia e Durrësit, por është në partneritet me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale edhe me WorldVision. Në këtë qendër kanë marrë shërbime akomoduese, që i bie shërbimin emergjent, strehim, ushqim, veshje, këshillimin psikologjik, por rastet me thënë të drejtën nuk është se menaxhohen brenda 72 orëve, lind nevoja që për shkak të procedurave që janë të tilla, proceset gjyqësore shkojnë përtej 72 orëshit, megjithatë këto raste janë mirëmenaxhuar. Përtej kësaj aty ka dhe shërbim ditor, ku ne ofrojmë shërbim sidomos për zonën përreth, për prindër të cilët marrin këshillime afatgjatë dhe programe prindërimi pozitiv. Programet e prindërimit pozitiv i kemi të shtrirë në të gjitha qendrat sociale, që ofrojnë shërbimet e kujdesit shoqëror.

Aktivitetet janë të ndryshme ne kemi dhe Qendrën e Reziliencës që sigurisht që ka vëmendje. Programet janë pak a shumë të njëjta në qendra, është pasur në fokus shtimi i shërbimeve sidomos në zonat rurale, megjithatë, në një projekt që kemi në mbështetje të USAID-it dhe në partneritet me Qendrën për Zhvillim Komunitar Për të Ardhmen, është Qendra e Reziliencës që ka në fokus fuqizimin, kryesisht të komuniteteve që janë në nevojë, ku mbështetjen më të madhe sigurisht që e kanë marrë gratë, sidomos ato që janë kryefamiljare, por ndërkohë ne kemi modeluar dhe shërbimin lëvizës të cilën e kemi pjesë të planit social, por edhe ndërkohë dhe pjesë të aktiviteteve, që janë në planin vendor për barazinë gjinore. Shërbimi lëvizës jo vetëm që indentifikon rastet, por ofrojmë shërbime edhe në familje. Për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje është një qasje multifunksionale, por dhe të mbrojtjes së fëmijëve dhe në këto raste ne ofrojmë shërbimin ligjor, linjën telefonike dhe këshillimin psikologjik.

Të gjitha këto mbulohen në fakt nga Bashkia Durrës, ku për këtë vit i kemi në proces tenderimi, por ndërkohë kemi dhe partneritetin me organizatat, që na mbështesin në menaxhimin e rasteve. Puna jonë nuk është e vetme është në partneritet të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile dhe aktorë të rëndësishëm siç që janë Njësia e Kujdesit Shëndetësor Vendor, Policia, Zyra Arsimore Vendore, Zyra Rajonale e Punësimit dhe shumë struktura të rëndësishme në Bashkinë Durrës. Ju faleminderit!

Flutura Kasa: Kam një koment për të bërë.

Ani Dyrmishi: Po, znj. Flutura.

Flutura Kasa: Pas 72 orësh si ndihmohen këto gratë e dhunuara? Se deri tani jam shumë e kënaqur me çfarë dëgjova. Puna është mbas asaj 72 orëshit çka ndodh?

Meme Xhaferaj: Punonjësja sigurisht që bën një vlerësim të rastit për nevojat që ka rasti dhe pas vlerësimit mblidhet grupi teknik ndërsektorial me përfaqësuesit që unë thashë. Jo çdo rast dhune në familje ka nevojë për punësim, dikush është i punësuar, jo çdo rast ka nevojë për strehim por mund të jetë shumë emergjente problemi i sigurisë. Dhe ne kur kemi raste të tilla që kërcënohet siguria e gruas sigurisht bashkëpunojmë ngushtë me Policinë dhe i kërkojmë një monitorim ose e mbajmë më gjatë rastin, derisa të strehohet në një qendër, që ofron shërbime më afatgjata.

Flutura Kasa: Dakord, faleminderit.

Edlira Shemsi: Dua të bëj dhe unë një pyetje,

Ani Dyrmishi : Po znj. Shemsi.

Edlira Shemsi: Doja të dija sa është numri i grave të dhunuara? Sa nga ato kanë marrë urdhër mbrojtje dhe kush ka qenë ndihma konkrete që keni dhënë? Sa është numri i grave me probleme në familje që kanë dhe probleme të natyrës sociale, numri që mund të keni regjistruar? Sa ka qenë ndihma konkrete e bashkisë apo e strukturave të tjera, që mund të varen nga bashkia?

Meme Xhaferaj: Po i referohem pjesës së buxhetit, po dal nga fundi te pika: Që sa ka planifikuar Bashkia Durrës? Bashkia Durrës ka planifikuar fondin prej 50 milion e 143 lekë, por kjo është fond, për funksionimin e qëndrave që ofron shërbimet e kujdesit shoqëror, jo Qendra Ditore e të Moshuarve, jo Shtëpia e Foshnjes, por qendra në të cilat zbatohen këto programe që punohet me këto gra.

Lidhur me numrin e rasteve të dhunës në familje që i referohet vitit 2023, unë tani këtu për momentin si shifër ekzakte se kam, por janë mbi 300 raste, që kanë marrë urdhra mbrojtje. Jo në gjithë rastet e urdhërave të mbrojtjes kanë nevojë për një menaxhim për t'i ofruar një sërë shërbimesh, shpeshherë rasti ka gjetur zgjidhjen bën çkurorëzimin, dikush jeton me prindërit, dikush largohet jashtë shtetit.

Nëse do të marim se sa raste iu është ofruar shërbime, sigurisht të gjitha rastet, që kanë pasur nevojë për shërbime ne i kemi referuar, ku ka pasur nevojë për shërbime të kujdesit shëndetësor, kur ka pasur nevojë për punësim. Për vitin 2023 bëmë analizën në janar janë 9 raste, të cilat janë punësuar, jo të gjitha, por dy raste kanë shkuar kanë marrë kurse të formimit profesional.

Ndërkohë lidhur me problematika, sfidë kanë mbetur problemet e strehimit, sepse nga informacionet që kam ato aplikohen, por nuk arrijnë t'i plotësojnë të gjithë dokumentacionet sipas kërkesave në fakt që kërkon ligji, sepse ligji thotë që duhet të kenë sipas edhe specialistëve të strehimit dokument të divorcit, janë procedura teknike por dua të them që nga ana jonë, analiza e nevojave të rasteve bëhet e thelluar.

Ndërkohë të gjitha rastet që kanë pasur nevoja ekonomike, ligji nuk e përjashton në fakt edhe ato që kanë të ardhura, mund të aplikojnë për ndihmë ekonomike, sigurisht që ne të gjithë i informojmë që të aplikojnë për të marrë ndihmën ekonomike dhe me ligj të gjitha rastet që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike janë trajtuar me ndihmë ekonomike, përtej shërbimeve të tjera, me paketa të ndryshme ushqimore sipas ndihmave emergjente apo këshillimeve psikologjike afatgjata, jo vetëm për gratë, por edhe për fëmijë apo kur ka pasur nevoja për shërbime shëndetësore apo strehim për në qendra të tjera pritëse. Kemi të gjithë përgjegjësinë t'i garantojmë mbrojtjen dhe një strehim të sigurt kur bëhet fjalë, pasi të dali nga emergjenca.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Edlira Shemsi: Problematikat janë, sepse ato që aplikojnë....

Ani Dyrmishi: Zonja Shemsi ju lutem!
Ju lutem!

Edlira Shemsi: Mbarova!
Ato që aplikojnë, nuk plotësojnë kriteret, që janë kritere shpesh absurde.

Ani Dyrmishi: O Eda !

Edlira Shemsi: Ato nuk kanë minimumin jetik. Ato detyrohen të jetojnë me bashkëdhunësin për shkak të mungesës për strehim dhe për shkak të kushteve, sepse nuk kanë të ardhura buxhetore për të mbajtur fëmijët dhe për hatër të ushqyerjes së fëmijëve ato vazhdojnë të jetojnë të dhunuara dhe vazhdon të degjenerohet dhuna dhe ndonjëherë në raste fatale.
Faleminderit!

Ani Dyrmishi: Zonja Shemsi, radhën tjetër duhet të marrësh leje kur të marrësh fjalën.

Edlira Shemsi: Me fal.

Ani Dyrmishi: Me fal dhe e bën shpesh këtë, përndryshe unë do të përjashtoj nga mbledhja e këshillit. Ka rregulla këtu, se ta marrin të gjithë fjalën kështu ç'a bëhet.

Tashi merr leje e fol. Të jap leje unë dhe fol.

Edlira Shemsi: Më fal zoti kryetar, por sa për shpesh, mbledhja e Këshillit Bashkiak është protokolluar dhe nuk e di se sa shpesh e kam bërë?

Ani Dyrmishi: Po, por zbatojmë gjithë rregullin këtu dhe kështu mbaron mbledhja.

Meme Xhaferaj: Lidhur me rastet që e kanë këtë ndihmë të nevojshme dhe shumë emergjente ne bashkëpunojmë ngushtë dhe me drejtori të tjera të Bashkisë së Durrësit, sidomos me Drejtorinë e Arsim-Kulturës, ku ne kemi pasur raste që kemi regjistruar fëmijët për të pëfituar kopshtin, për të pëfituar çerdhen dhe e kanë pëfituar edhe falas, në rastin që kanë pasur problematika të tilla dhe nevoja për shërbime të tilla. Po në 320 e ca urdhëra, thashë jo të gjithë kanë pasur nevojë për shërbime emergjente, sepse në fakt që t'ia ofrosh shërbimin duhet dhe që ta pranosh. Shumë herë rastet kanë gjetur mbështetjen e familjarëve apo siç thashë janë larguar, nuk kanë kërkuar të gjitha këto shërbime që ne mundemi t'i ofrojmë, nuk i kanë pranuar. Kur personi është madhor, në radhë të parë duhet të jetë dëshira e tyre për të pranuar shërbimet dhe ofruar ato.

Ani Dyrmishi: Faleminderit.

Koment tjetër?

Nuk ka. Atëherë Faleminderit znj. Xhaferaj.

- **Pika 20**, I japim fjalën për “Raportim mbi auditimin e brendshëm të ndërmarrjeve në varësi të bashkisë për vitin 2023” Znj. Oneda Deliallisi.

Oneda Deliallisi (Drejtoresh e Auditit të Brendshëm në bashki): Përshëndetje!

Si çdo vit Njësia e Auditit të Brendshëm, bën raportimin e tij vjetor në Ministrinë e Financave në Këshillin Bashkiak Durrës. Kjo njësi mbështet menaxhimin e lartë të bashkisë dhe institucionet e varësisë për të arritur objektivat e tyre. Kjo njësi ushtron veprimtarinë e saj në varësi të planit strategjik dhe planit vjetor të miratuar nga kryetari i bashkisë.

Për vitin 2023 janë planifikuar 9 auditime, por janë realizuar vetëm 7, për arsye të daljes në pension të drejtorit të njësisë, në 6 mujin e dytë të vitit 2023. Kanë qenë 3 auditime përputhshmërie dhe 4 auditime të kombinuara.

Subjektet e audituara janë, 5 Njësitë Administrative, Drejtoria e MZSH-së, Drejtoria e Shërbimeve, Sektori i Prokurimeve, Qendra Ekonomike e Arsimit, zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së dhe të auditimit të brendshëm dhe Ndërmarrja Komunale Plazh.

Në auditimet e kryera janë lënë dhe pranuar 58 rekomandime, të gjitha janë masa administrative, nuk ka çështje të dërguara për investigim dhe nuk ka masa për dëm ekonomik. Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara janë rekomanduar masa organizative që bëjnë të mundur mospërsëritjen e këtyre problematikave, që janë hasur gjatë realizimit të këtyre objektivave, dhe disa nga fushat që janë me risk të lartë dhe që auditit ka pikasur janë:

- sistemet e administrimit të pronës dhe pasurive, për të cilat janë lënë 6 rekomandime,
- sistemet e prokurimeve blerjeve dhe investimeve ku janë lënë dhe pranuar 13 rekomandime,

- sistemet e pagesave, shpërblimeve dhe trajtimeve, ku janë lënë dhe pranuar 3 rekomandime.
- Më tej pas konstatimit të risqeve dhe sisteme të tjera janë lënë 35 rekomandime të ndryshme për përmirësimin e këtyre risqeve.

Gjatë raportimit të këtij raporti kanë qenë 29 rekomandime, të cilat janë zbatuar dhe 29 rekomandime në proces zbatimi.

Një detyrë kryesore në auditimin e një subjekti është dhe vlerësimi i kontrollit të brendshëm. Në përgjithësi ndërmarrjet e varësisë funksionojnë mirë. Ato kanë vendosur rregullat të cilat ndiqen në mënyrë hierarkike. Pjesërisht institucionet kanë regjistër risku, është bërë dhe ndarja e detyrave dhe informacionin pra ndryshimet ligjore dërgohet në kohë dhe në mënyrat e duhura.

Si konkluzion me gjithë punën e mirë në vlerësimin e kontrollit të brendshëm në disa raste kemi lënë rekomandime për përmirësimin e punës në subjektet e varësisë.

Ani Dyrmishi: Ka ndonjë koment për këtë pjesë?

Komente nuk ka, faleminderit.

Oneda Deliallisi: Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Kalojmë në **pikën 21**. Duke qenë se zëvendëskryetari që largohet nga këshilli i përket grupit të Partisë Socialiste ftoj Kryetarin e grupit të bëj propozimin përse i përket kandidatit.

Rolant Xhelilaj: Faleminderit Kryetarit të Këshillit.

Përprara se të bëj propozimin në emër të grupit, duke ju kërkuar mirëkuptim të gjithë palëve desha të theksoj me dy fjalë pikën 11, ku bëhet fjalë për vënien e emrit Moikom Zeqo lulishtes në hyrje të Durrësit. Është një vendim që u mor unanimisht nga gjithë Këshilli Bashkiak që na bën nder të gjithë në anëtarëve të Këshillit Bashkiak.

Me këtë rast falenderojmë dhe Kryetaren e bashkisë për propozimin, shumë të rëndësishëm dhe të mirë të bërë, për faktin se Moikom Zeqo për Durrësin përfaqëson një figurë komplekse, shkrimtar, arkeolog, person me dinjitet, i cili ka punuar fort jo vetëm për Durrësin, por dhe për vendin dhe në këtë rast ne atë kontribut të madh që ka dhënë gjatë gjithë jetës së tij ja kthejmë me një respekt me një lulishte që është në hyrje të Durrësit, kështu që faleminderit të gjithë Anëtarëve të Këshillit që votuan, faleminderit Kryetare për propozimin.

Tani në emër të grupit duke pasur parasysh që nënkryetarja është zonjë ne themi të mbetemi tek e njëjta linjë dhe propozojmë zonjën Denisa Luarasi, s'besoj që ka nevojë t'i bëjë koment, Denisa është dy herë rresht anëtare e këshillit bashkiak.

Ani Dyrmyshi: Votimin po e bëjmë të hapur. E hedhim në votim.

Kush është pro me zgjedhjen e znj. Denisa Luarasi si zëvendëskryetare e Këshillit Bashkiak?

Kundra?...

Abstenim?... Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro znj. Denisa Luarasi zgjidhet zëvendëskryetare e Këshillit Bashkiak.

Ju uroj për detyrën znj. Luarasi.

Denisa Luarasi: Ju faleminderit kryetar, ju faleminderit anëtarëve të këshillit. +

Ani Dyrmishi: Ka kërkuar fjalën **për diskutim** z.Jonuz Myshketa.

Jonuz Myshketa: Kam disa pika për të trajtuar.

T'i them pikat një e nga një apo përnjëherë znj. Kryetare?

Emiriana Sako : Lexoi të gjitha, pastaj kthej përgjigje.

Jonuz Myshketa: Okej (okay), po lexoj pikën e parë. Duke patur parasysh që Durrësi është një qëndër kulturore në ballkan, ka një vëmendje më të veçantë në lidhje me restaurimin e siteve arkeologjike dhe dhënia parësi e tyre të një rëndësie të veçantë. Do doja që të futej, të rishikohej në buxhetin e Bashkisë Durrës restaurimi dhe vendosja e një pankarte përkujtimore në ish-burgun e vjetër. Kjo bëhet në nder të personave të burgosur gjatë Luftës Dytë Botërore, gjatë fashizmit, por është dhe një nga monumentet e rëndësishëm. Për shkak të vlerës që ka duhet të njihet nga gjithë brezat historia e vjetër këtij siti arkeologjik. Godina e burgut të vjetër, më lejoni një histori të shkurtër, është nga godinat më të vjera, e cila daton që në vitet 1500, nga vitet 45 deri në vitet 54 ka shërbyer si burg, ku janë izoluar qindra qytetarë, të burgosur, kundërshtarë të regjimit. Aty ku duhet të vë theksin, në atë burg janë burgosur disa nga klerikët më të rëndësishëm të qytetit të Durrësit. Në vitin 1830-1850 është burgosur myftiu Mustafa Varoshi.

Flutura Kasa : Kryetar ne nuk dëgjojmë.

Ani Dyrmishi : Gërthit pak të lutem.

Jonuz Myshketa: Janë burgosur në këtë burg imzot Jul Bonati dhe imzot Vincent Prenushi, të dy të njohur si “martirë” nga Vatikani. Kjo godinë duhet të marrë kujdesin nga pushteti vendor, ndaj propozojmë atë që thamë më sipër, kërkojmë pllakatë përkujtimore dhe mundësinë e investimit dhe restaurimin të kësaj pjese. Kjo ishte përsa i përket pikës së parë.

Ani Dyrmishi: Pyetja e dytë?

Jonuz Myshketa: Pika e dytë është krijimi i adresatit, sistemit të adresave sipas lagjeve dhe fushave profesionale me tematika të ndryshme që ka në vëndin tonë si dhe në vendet e tjera Kroaci, Korfuz, si lagjjet e artistëve, lagjjet e shkrimtarëve, lagjjet e piktorëve e mjekëve e të tjera me radhë dhe për të vendosur numër civil për çdo banesë në shkallë ku dhe njehësojmë sistemin e adresave, në varësi të kodit urbanistik ndërkombëtar, siç njihet dhe kodi i Bonapartit. Kështu krijojmë dhe lagje dhe zona ekonomike të ngjashme dhe të filloj nga krahu më i afërt me qendrën e qytetit.

Shqetësim tjetër kam është shkëputja e kabujve dhe telave që qëndrojnë në gjithë qytetin. Besoj është një pamje e trishtë kur e shohim për Durrësin turistik. Të krijohet një sistem për t'u vendosur nëntokë në bashkëpunim me institucionet përkatëse siç mund të jetë OSSHE-ja e të tjera me radhë. Një pikë tjetër që përbën problem apo është një kartolinë e shëmtuar nga ajo ç'ka ofron Durrësi turistik është mbulimi i ish hotel Vollga. Gjykoj të vendoset, ka nevojë për investim. Mendoj që këshilli bashkiak duhet ta miratojë për atë ç'ka prodhon është siç vendoset kudo nëpër botë një pamje siç ka qënë Vollga, hoteli. Pavarësisht se është një pronë private, por sipërfaqja e asaj fasade është e të gjithëve ne dhe e rikthen në gjëndjen e saj të mëparshme të paktën nga pamja vizuale dhe heq atë imazh të trishtë që është në këtë moment. Duke uruar dhe parandalim dhe hyrjen e disa personave për një shërbesë publike për nevojat personale.

Një pikë tjetër kyçe është ndalimi i të miturve dhe nënat me infant në krah, që kërkojnë lëmshë rrugëve të qytetit, nëpër kryqëzime, në shëtitorën Taulantia. E para që është një vepër penale shfrytëzimi i të miturve dhe e dyta është një pamje e trishtë për ne si qytetar dhe aq më tepër që Durrësi përgatitet për prag të sezonit turistik. Duhet një vëmëndje nga Bashkia, Policia Bashkiake, Policia e Rendit, besoj që duhet zgjidhur në mënyrë imediate. Asnjë nga ne nuk do donte të shihte fëmijën në një gjëndje të tillë.

Duke patur parasysh Durrësin turistik do të gjykoja krijimin e një zone ekonomike turistike për sezonin veror për fashën e të rinjve si vendas ashtu dhe të huaj. Ashtu siç ka një fashë të rriturish që kërkojnë qetësi pas mesnate, ka dhe një fashë të rinjsh që kërkojnë një zonë ku të kenë mundësi të kalojnë orët e vona nën tingujt e muzikës të papenalizuar nga fashat orare. Dhe kjo është në të mirë të biznesit dhe në të mirë të bashkisë për të vjelur të ardhura.

Vendosja e pikave informative për turistët të jenë të lëvizshme duke tregtuar dhe imazhin e qytetit, logon e qytetit "I love Durrës", ka plotë Durrësi që mund të atamohet si një emblemë e tij.

Dhe e fundit jo nga rëndësia është krijimi i ambjentëve për nevojat higjenike, si tualete dhe dushe ose çezma për shpëlarjen e trupit nga uji i kripur, pse jo dhe me vetfinancim kundrejt tarifave të volitshme për qytetarët dhe pushuesit. Besoj se asnjë nga qytetarët që do të kenë akses do të kenë problem për një pagesë .

Këto ishin disa nga pikat që unë doja të parashtroja. Më tepër janë pika sygjerime për të patur një Durrës gati për sezonin turistik. Duke i dhënë mundësinë dhe bizneseve dhe ne që të jemi sa me dinjitoz në pritjen e tyre, të cilët janë burim të ardhurash për bizneset. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Po, Kryetare.

Emiriana Sako: Faleminderit për ndërhyrjen.

Sa i takon ish-burgut që ndodhet pas Muzeleumit të Dëshmorëve, ne në fakt nuk e kemi si aset të bashkisë së Durrësit, por para 2-3 javësh kemi pasur një bisedë me Ministrinë e Ekonomisë Kulturës, Inovacionit pikërisht për të vlerësuar mundësitë që mund të ketë kthimi i këtij objekti, pra restaurimi i tij dhe kthimi i vizitueshëm për të treguar dhe atë pjesë të historisë që ju përmendët. Mendoj që vendosja e një pankarte memoriale në një objekt, që nuk është i aksesueshëm mundet të na bëjë qesharak deri diku, edhe pse nuk na kushton gjë që të vendosim një pankartë aty për të informuar edhe qytetarët që kalojnë, por do të ndjekim me prioritet bashkëpunimin me ministrinë, jo vetëm për këtë objekt, por dhe për asete të tjera të trashëgimisë

arkeologjike kulturore që kemi në qytetin tonë, siç kemi vepruara në rastin e shkollës Eftali Koçi, por edhe me gjetjet që po bëhen në shkollën Gjergj Kastrioti për të bërë vlerësimin dhe sigurinë e tyre sipas vendimmarrjes së arkeologëve.

Sistemi i adresave është një proces që është realizuar, le të themi para 6 apo 7 viteve nga Ministria e Brendshme nga Gjendja Civile, është bërë një punë e madhe në terren, por rast pas rasti dhe me buxhetin tonë dhe me vendosjen e investimit për sinjalistik në qytet të bëjmë të mundur atje ku mungon sinjalistika për të bërë investimet e nevojshme. Ndarja e zonave, pra ju thoni që duhet të ketë një sistem adresash dhe një ndarje të zonave me lagje, pra lagjja e artistëve apo të paktën kështu e përmendët.

Jonuz Myshketa: Po sepse duhet t'i jepet prioritet...

Emiriana Sako: Kjo vjen edhe nga trashëgimia kulturore që ka edhe vetë qyteti, sigurisht që marrim shembull qytetet e mëdha, që e kanë këtë gjë të ngritur, por e kanë sepse kanë pasur një pjesë të kulturës të zhvilluar në këtë formë, dhe nuk duam që të jemi kopje e qyteteve të tjera, por nxjerrim në pah atë potencial që ka qyteti i Durrësit me një histori të jashtëzakonshme dhe pikërisht për këtë arsye kemi prej tre vitesh tashmë firmosur marrëveshjen me Fondin Amerikan të Zhvillimit, Ministrinë e Kulturës dhe Ekonomisë dhe Inovacionit për të rehabilituar lagjien e qendrës së qytetit, i cili do të ketë këtë koncept që të revitalizojë komplet qendrën, të nxjerrim në pah ato objekte, që janë pjesë e trashëgimisë kulturore, të adoptojë objektet, pra t'i japi një mundësi atyre që banojnë sot në këtë zonë që ta kthejnë në një biznes të vogël në shërbim të turizmit. Mendojmë që, mund të fillojë shpejt projekti pasi buxheti varet nga ADF- ja dhe ne kemi bërë ato pjesët që na takojnë si institucion, por jemi të sigurt që me fillimin e punës do të ketë një impakt pozitiv në zonë.

Mbulimi, heqja e telave dhe kabllave është një proces që e kemi filluar atje ku kemi bërë ndërhyrje në infrastrukturë, pra në zonën e lagjjes 18, që kemi bërë komplet reabilitimin e fasadave të objekteve që ndodhen aty, rreth 40 pallate janë në lagjjen 18, 16 objekte të tjera janë në lagjjen 16, jemi duke aplikuar për lagjjen 12 për të bërë një pjesë tjetër të pallateve parafabrikat. Gjatë procesit që bëhet reabilitimi i tyre marrim masa dhe për heqjen e kabllave nga fasadat apo objekteve nga lagjjet. Duhet një bashkëpunim me kompanitë internetit dhe kryesisht ato janë dhe në fakt i kemi njoftuar kemi mbajtur dhe një letër këmbim kemi bërë dhe një takim në zyrë, është një proces që do të kërkojë kohën e vet pasi rrjeti është shumë kompleks dhe shumë i shtrirë, në shumë objekte pallate banimi, kryesisht në qendër të qytetit të Durrësit. Mendojmë që, do të vazhdojmë punën në lagjjen 17, sepse edhe aty rruga e ujësjellësit “Dalip Peza” ka dhe ajo një ngarkesë me këtë problematik.

Hotel Vollga ose ish-hotel Vollga, kemi parë mundësinë e financimit vetë, por duke qenë një pronë private, mund të ekspozohet investimi ndaj një rrisht, që do të thotë, në rast se ne bëjmë një veprim, bëjmë një procedurë dhe shkojmë e veshim atë objekt me një fasad apo veshje fotomontazh e të tjera me radhë, ne nuk dimë se çfarë do të ndodhi me objektin, pra investitorët kanë në plan që ta zhvillojnë, dhe kjo gjë mund të ndodhi për një kohë të shkurtër, pasi ne bëjmë investimin. Objektiv kryesor kemi qëndueshmërinë e objekteve, që bëhen me fondet e bashkisë, pra me fondet publike dhe jetëgjatësinë e tyre, dhe për këtë arsye kemi bërë një vlerësim dhe i

kemi kërkuar donatorëve të ndryshëm në rast se mundet të bashkëpunojnë me bashkinë e Durrësit, për të bërë dhe një farë promocioni të produkteve të tyre, por edhe për ta mbuluar si objekt se është realisht një pikë që nuk është e hijshme ta kemi në atë formë në qytet.

Ndalimi i të miturve dhe nënave me infant, është vepër penale, ndiqet nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me Policinë Bashkiake. Vjet që në fillim të sezonit kemi marrë masat që të zbehet fenomeni, të largohen nga rruga, vijnë nga qytete të tjera në qytetin e Durrësit, sepse ka lëvizje dhe fëmijët i nxjerrin për të luajtur në rrugë, e kemi denoncuar këtë gjë dhe kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë me Policinë e Durrësit dhe do ta bëjmë vazhdimisht këtë gjë. Ju falenderoj për denoncimet, por edhe konkretisht do të ishte mirë, pra mos të flasim vetëm në parim, por në rast se do të keni denoncime gjatë ditëve të ndryshme, mirë është që të kemi një kontakt direkt, qoftë me bashkinë, por edhe me policinë e shtetit, sepse kjo përbën një vepër penale.

Krijimi i një zone me muzikë të lartë, pra ku lejohet muzika apo ekonomike le ta quajmë, është një detyrim i bashkisë së Durrësit me ndryshimin e ligjit të 2007 që ndodhi në vitin 2023, kemi një detyrim për të hartuar një masterplan “Për lejimin e zhurmave” e citon ligji, pro muzikës së lartë, le të themi. Jemi duke parë mundësinë që të vlerësojmë kryesisht zonën e Currilave dhe deri pjesa që shkon drejt Kallmit, sepse ajo është një zonë që ka më shumë të rinj gjatë periudhës së verës, por meqenëse ne jemi në fazën e hartimit të një plani jemi të hapur dhe për propozimet tuaja që të bëni vlerësime, që të jetë sa më gjithëpërfshirës ky material, do të miratohet nga Këshilli Bashkiak dhe besojmë që brenda muajit qershor do të kemi një propozim konkret.

Nga ana tjetër me rishikimin e buxhetit që miratuar sot, ne kemi bërë të mundur edhe një kërkesë të Policisë Bashkiake, pra kemi futur investim për blerjen e matëseve të zhurmave atje ku ka ankesa nga banorët. Policia Bashkiake do të pajiset me këto instrumenta dhe do të ketë aftësinë për ta matur nivelin e decibel të zhurmës, që ndodhin në zona të caktuara atje ku kanë ankesa banorët apo edhe ku do të lejohen me planin e ri.

Pikë tjetër ishte vendosja e pikave informative për turistët, siç e thashë ne me sinjalistikën që vendosim çdo vit kemi prioritet zonat turistike, në mënyrë që vizitorët, turistët të kenë një aksesueshmëri sa më të mirë, qoftë për të gjendur hotelet, baret, restorantet por edhe atraksione të tjera që ofron zona e plazhit, zona e bregdetit le të themi.

Dhe krijimi i ambienteve për nevojat higjnikë, pjesë e shëtitores së plazhit, në fazën e parë që realizuam ishte dhe vendosja e këtyre gabinave për ndrim. Nyje sanitare janë ndërtuar para disa vitesh nga bashkia e Durrësit janë vandalizuar 100% nga qytetarë, banorë e të tjera me radhë dhe ne nuk e shikojmë si zgjidhje që t’i vendosim ato kudo, pra sepse ato kthehen jo si një pikë shërbimi, po si një burim problematik pastaj, kështu që në bashkëpunim me subjekte, të cilat kanë kontrata me bashkinë për të operuar për plazhet private, atyre i kemi kërkuar që të marrin masat për t’i vendosur dhe numri i tyre sigurisht nuk është nevoja që të jetë kaq i shpeshtë përgjatë zonave, por të ketë një akses sa më të mirë përsa i takon turistëve.

Ani Dyrmishi: Faleminderit Kryetare.

Ju faleminderit të gjithëve dhe mbledhjen e deklaroj të mbyllur!

Edlira Shemsi : Zoti Kryetar, diçka duhet të thojë .

Ani Dymishi: Duhet të regjistrohesh për të marrë fjalën.
S'je regjistruar, kështu që nuk e merr.

Edlira Shemsi: Në mbështetje të grave me probleme sociale dhe të dhunës, si kryetar i këshillit intimiduat një grua.

Ani Dymishi: Ju lutem, mbledhja u mbyll.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 25 (njëzetëepesë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i procesverbalit: Enxhi Gjuzi

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Zëvendëskryetar i Këshillit :

DENISA LUARASI

Zëvendëskryetar i Këshillit :

EDLIRA DEVOLLI

Kryetar i Gr. Partisë Socialdemokrate:

FLUTURA KASA